

RESISTENZA DEGLI ALBANESI DEL MOLISE

Gli sportellisti linguistici dei paesi albanesi del Molise (Montecilfone, Portocannone, Ururi, Campomarino) non si arrendono, ma insistono per consolidare la loro professionalità e fare fronte agli impegni che si presentano esigenti da richiedere una qualificata preparazione.

La Regione Molise ha organizzato un corso di formazione (3 – 12 dicembre 2009) destinato, appunto, agli sportellisti linguistici, coordinato dalla Prof.ssa Fernanda Pugliese, animatrice instancabile della cultura arbëreshe. Il corso è stato tenuto dal Prof. Italo Costante Fortino, ordinario di Lingua e Letteratura Albanese all'Università di Napoli L'Orientale, e dalla Prof.ssa Merita Bruci, assegnista di ricerca presso L'Orientale di Napoli, i quali hanno insistito sugli aspetti linguistici, per consolidare le conoscenze delle parlate locali, messe a confronto anche con quelle arbëreshe delle altre Regioni dell'Italia meridionale. Al contempo i due esperti hanno trattato sia della cultura orale (novellistica, rapsodie, tradizioni popolari), sia di quella colta letteraria, abbracciando la fase più antica dei secoli XVI – XVIII, quella del Romanticismo e del Novecento, con una scelta di brani antologici letti, analizzati e interpretati.

Questo corso di aggiornamento, intensivo e obbligatorio per gli sportellisti, svolgeva le sue attività, proprio mentre la Regione Molise apportava modifiche al suo Statuto, inserendo come punto qualificante la valorizzazione delle minoranze linguistiche, arbëreshe e croata, presenti nella Regione, in quanto rilevante patrimonio regionale e nazionale, meritevole della massima attenzione e sostegno, e in particolare di un vero rilancio con criteri sempre più efficaci, perché apporti non solo ricchezza intellettuale, ma anche economica, se solo pensiamo a quanto realizzano gli operatori delle altre minoranze linguistiche del Nord Italia.

In considerazione dell'importanza dell'autoformazione permanente che deve animare gli sportellisti, oltre ai due filoni didattici di cui sopra, i docenti del corso hanno prospettato agli sportellisti, un piano di ricerca che mira a rendere più palese, - facendola emergere dallo stato di assopimento o di relativo abbandono, - quella cultura sommersa arbëreshe che spesso viene con sufficienza accantonata perché ritenuta inefficace e poco redditizia.

Soprattutto oggi, come ha ben messo in luce con profonde cognizioni scientifiche l'antropologo Levis Straus, il "particolare" merita di essere apprezzato e vissuto, convinto che possa convivere in pace accanto al "generale". Nessuno vieta che nel "particolare", cioè a Montecilfone, Portocannone, Campomarino, Ururi, si continui a parlare la lingua materna, ad eseguire canti tradizionali, a cucinare secondo la propria usanza, ad apprezzare le feste tradizionali, e, là dove si è conservato il rito bizantino, a cantare nelle sacre funzioni in lingua albanese; senza rinunciare ai benefici che provengono dalla globalizzazione: l'uso dell'inglese per comunicare con tutto il mondo tramite internet, l'uso di computer veloci che facilitino la navigazione, l'acquisto di oggetti online a prezzi favorevoli, la consultazione di milioni di libri che ormai si trovano su siti online, la sperimentazione di curiose ricette internazionali che possano soddisfare le nostre esigenze di palato, e quant'altro.

Il piano di intervento che potranno concretizzare gli sportellisti, pertanto, si esplica, con metodologie moderne, nell'ambito del tessuto culturale locale per realizzare una mappatura di quanto resta della cultura locale, operando su due direzioni:

a) la lingua nella sua complessità, **b)** la cultura in senso ampio.

- a)** Per quanto concerne la lingua si tende a rilevare la sua struttura con supporto multimediale, video e sonoro, oltre che con quello cartaceo. La ricerca ha come finalità la presentazione della lingua parlata oggi nelle singole comunità, con una duplice funzione: 1) quella di documentazione fedele per un archivio usufruibile anche tramite i canali di internet, 2)

quella pratica per la didattica che si rivolge a quanti, - alunni, studenti, adulti - vogliono alfabetizzarsi nella lingua materna e approfondirne le conoscenze a più livelli.

La presentazione strutturale della lingua arbëreshe locale trova la sua base documentaria in registrazioni (sonore e video) mirate ai singoli argomenti e in registrazioni a più ampio raggio che interessano tanto la novellistica, quanto la descrizione di momenti relativi al ciclo dell'uomo e dell'anno.

b) Anche la cultura in senso lato si avvale del supporto multimediale: la cultura **folklorica** che abbraccia il ciclo dell'anno e quello dell'uomo - la **storica**, per registrare quanto è depositato nella memoria popolare e nei documenti scritti; - la **letteraria popolare** presentata nel testo originale della versione locale, - la **letteraria colta**, dalle origini ai nostri giorni, con l'evidenziazione delle varietà linguistiche; - la **musicale popolare**, con attenzione al testo e ai modelli musicali.

L'intervento più urgente, tuttavia, riguarda il patrimonio lessicale che è quello più esposto a rischio. Quando un arbëresh si accinge a scrivere nella propria lingua materna incontra la maggiore difficoltà proprio nel lessico che non copre tutto il ventaglio espressivo.

Per ogni comunità, pertanto, si rendono urgenti alcune operazioni: a) raccogliere tutto il patrimonio lessicale esistente, b) recuperare quello più raro (spesso assente anche nei comuni repertori), che a stento viene inteso dalle nuove generazioni, c) procedere a ritroso per recuperare quello dimenticato oggi da tutti, d) attingere al lessico esistente nelle altre comunità arbëreshe, e) ricorrere alle fonti letterarie che rispecchiano il lessico tradizionale.

Un progetto di ricerca così articolato avrà come risultato: a) la raccolta di un ricco patrimonio culturale, linguistico e lessicale che faciliterà la scrittura, b) l'avvio di un processo di autoformazione negli sportellisti, atto a garantire loro una elevata professionalità.

SHQIPTARËT E MOLIZES MBAHEN ENDE FORT

Sportelistët gjuhësorë të fshatrave të Molizes (Monteçilfone, Portokanone, Ururi e Kampomarino) nuk dorëzohen, por vazhdojnë me këmbëngulje të përmirësojnë profesionalitetin e tyre dhe të përballojnë kërkesat që u shtrohen për ta pasuruar këtë kualifikim.

Regjioni i Molizes organizoi në ditët e para të dhjetorit (3-12 dhjetor 2009) një kurs formimi për sportelistët gjuhësorë, nën bashkërendimin e prof. Fernanda Puliezes, animatore e palodhur e kulturës arbëreshe. Kursi u mbajt nga Prof. Italo Costante Fortino, profesor ordinar i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Studimeve të Napolit “L’Orientale” dhe Prof. Merita Bruci, docente e filologjisë shqipe pranë po këtij universiteti. Ata e përqendruan vëmendjen e tyre në aspektet gjuhësore, në forcimin e njohurive lidhur me të folmet lokale dhe dallimet e tyre me të folmet arbëreshe të regjioneve të tjera të Italisë Jugore. Të dy ekspertët folën si për kulturën gojore (fondi i përrallave, rapsoditë, traditat popullore) ashtu edhe për letërsinë e kultivuar, duke përfshirë në trajtesat e tyre fazën më të vjetër të shekujve XVI-XVIII, atë të Romantizmit dhe të viteve ‘900; e gjitha kjo e shoqëruar edhe me copëza të zgjedhura nga veprat origjinale të autorëve arbëreshë, të analizuar dhe të komentuar.

Ky kurs kualifikimi intensiv dhe i detyrueshëm për sportelistët gjuhësorë u mbajt bash në kohën kur Regjioni i Molizes aprovoi modifikimet në statutin e tij, duke shtuar si një pikë të rëndësishme vlerësimin e pakicave gjuhësore, arbëreshe e kroate, të pranishme në këtë regjion, si një pasuri regjionale dhe kombëtare, që meritojnë vëmendjen dhe mbështetjen më të fuqishme, dhe në veçanti një ringjallje më efikase, për të sjellë jo vetëm pasuri kulturore por edhe ekonomike, nëse kemi parasysh këtu atë që realizojnë operatorët e pakicave të tjera gjuhësore në Italinë e Veriut.

Duke pasur parasysh rëndësinë e vetformimit të vazhdueshëm që duhet të karakterizojë sportelistët, përveç dy linjave didaktike të sipërpërmendura, docentët e kursit u ravijëzuan sportelistëve, edhe një plan kërkimi që synon të bëjë të dukshme – duke e nxjerrë nga gjendja e përgjumjes dhe e indiferencës – kulturën arbëreshe të mbuluar nga tisi i pluhurit, pasi konsiderohet pa efekt dhe pak përfitimsjellëse, e për pasojë edhe e lënë pas dore.

Për më tepër sot, siç e ka vënë në dukje me njohuri të thella shkencore, antropologu Levis Straus “e veçanta” meriton të jetohet e të vlerësohet, e bindur se mund të bashkëjetojë në paqe pranë “së përgjithshmes”. Askush nuk mund të ndalojë që në “të veçantën”, pra në Monteçilfone Portokanone, Ururi e Kampomarino, të vazhdojë të flitet gjuha e mëmës, të këndohen këngë të traditës, të gatuhet sipas mënyrës së tyre, të shijohen festat tradicionale, dhe, aty ku është ruajtur riti bizantin, të këndohet në gjuhën shqipe në shërbesat e shenjta; pa hequr dorë nga të mirat që sjell globalizimi: përdorimi i anglishtes në komunikimin me të gjithë nëpërmjet internetit, përdorimi i kompjuterave të shpejtë që lehtësojnë lundrimin, blerja e sendeve *on-line* me çmime të favorshme, konsultimi i milionave libra që gjenden tanimë në sitet *on-line*, eksperimentimi i recetave ndërkombëtare të gatimit nga më të çuditshmet në shijim, e sa e sa të tjera.

Plani i ndërhyrjes që mund të vënë në jetë sportelistët, ndihmohet me një metodologji moderne, në bazë të situatës kulturore vendase, dhe synon një dokumentim të kulturës vendase, duke vepruar në dy drejtime:

a) gjuha në tërësinë e saj, b) kultura në një vështrim shumë të gjerë

a) Sa i përket gjuhës synohet të zbulohet struktura e saj, me një mbështetje regjistrimesh me zë dhe figurë, përveç botimit në letër. Kërkimi kërkon të realizojë paraqitjen e gjuhës së folur në gjendjen e sotme për secilin nga komunitetet, me një funksion të dyfishtë: 1) atë të një dokumentimi besnik për të krijuar një arkiv të shfrytëzueshëm edhe nëpërmjet kanaleve të internetit, 2) atë praktik didaktik për nevoja të mësimdhënies të shfrytëzueshëm nga të gjithë – nxënës, studentë, të rritur – si për alfabetizimin në gjuhën e mëmës, ashtu edhe për të thelluar njohuritë në nivele më të larta.

Paraqitja e strukturës vendase të arbërishtes do të bazohet mbi regjistrime me zë dhe figurë, të parashikuara për argumente të veçanta, si dhe në regjistrime me një rreze më të gjerë, që lidhen si

me fondin e përrallave ashtu edhe me përshkrimin e momenteve që kanë të bëjnë me ciklin e jetës së njeriut dhe të kalendarit vjetor.

b) edhe kultura do të përfitojë nga mbështetja multimediale: kultura **folklorike** që përfshin ciklin e vitit dhe të jetës së njeriut – ajo **historike**, për të regjistruar atë çka është shtresëzuar në kujtesën popullore dhe në dokumentet e shkruara – **letërsia popullore** e paraqitur në versionin vendas – **letërsia e kultivuar** nga origjina deri në ditët tona, me një evidentim të varietetit gjuhësor; - **muzika popullore** me një vëmendje të drejtuar si nga teksti ashtu edhe nga modelet muzikore.

Ndërhyrja më urgjente, megjithatë, duhet bërë në pasurinë leksikore, vetvetiu më e ekspozuar ndaj rrezikut të humbjes. Kur një arbëresh i vihet punës të shkruajë në gjuhën e tij të mëmës has një vështirësi të madhe sidomos në fushën e leksikut, i cili nuk arrin të mbulojë të gjithë mjetet e shprehjes.

Për çdo komunitet pra, mbeten të bëhen disa ndërhyrje urgjente: a) të mblidhet e gjithë pasuria leksikore ekzistuese, b) të rikuperohet leksiku më i rrallë (ai që mungon shpesh edhe në repertorin e përbashkët), që kuptohet edhe nga brezat e rinj, c) të rikuperohet leksiku i harruar sot nga të gjithë d) të shfrytëzohet si burim edhe leksiku që gjendet në komunitetet e tjera arbëreshe e) të shfrytëzohet si burim edhe leksiku veprave letrare që pasqyrojnë leksikun tradicional.

Një projekt i tillë kërkimi i konceptuar kështu mund të ketë si rezultat: a) mbledhjen e një pasurie të madhe kulturore, gjuhësore e leksikore që do të lehtësojë të shkruarit, b) fillimin e një procesi vetformimi ndër sportelistët gjuhësorë, gjë që do të rriste edhe profesionalitetin e tyre.